



DEKLARATË PRELIMINARE

Prishtinë, 8 tetor 2019

Zgjedhje të administruara mirë dhe transparente të prekura nga fushë-loja e pabarabartë dhe të cenuara nga frikësimi dhe mungesa e konkurrencës në trevat e banuara me serbë të Kosovës.

Kjo deklaratë preliminare e misionit të vëzhgimit të zgjedhjeve të BE-së (EU EOM) publikohet para përfundimit të procesit zgjedhor. Mbeten pa u kryer fazat kritike, ku përfshihen numërimi i votave me kusht dhe me postë, tabelimi i rezultateve dhe shqyrtimi i ankesave. EU EOM tani është në pozitë vetëm për të komentuar rreth vëzhgimit të kryer gjer më tani dhe më vonë do të publikojë raportin përfundimtar, duke përfshirë analizën e plotë dhe rekomandimet për forcimin e proceseve zgjedhore në të ardhmen. EU EOM gjithashtu mund të bëjë deklaratat të tjera lidhur me çështjet zgjedhore, kur dhe ku e konsideron të përshtatshme.

Përmbledhje

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare ishin të administruara mirë dhe transparente. Dita e zgjedhjeve ishte e rregullt, dhe vëzhguesit e EU EOM e vlerësuan pozitivisht votimin dhe numërimin. Fushata ishte e gjallë dhe konkurruese duke i lejuar garuesve të bëjnë fushatë lirshëm në pjesën më të madhe të Kosovës. Mirëpo, ambienti i fushatës në trevat e banuara me serbë të Kosovës u cenua nga frikësimi, duke vënë në shënjestër kandidatët dhe përkrahësit që nuk ishin rreshtuar me Srpska Lista. Keqpërdorimi i resurseve publike dhe mungesa e transparencës rreth financimit të fushatës rezultuan në një fushë-lojë të pabarabartë në të gjithë Kosovën. Përsëritja e problemeve sistematike në procesin zgjedhor të identifikuar edhe nga misionet e mëparshme të vëzhgimit që duhet të adresohen urgjentisht si prioritet pas formimit të qeverisë së re, në mënyrë që ta sjellin Kosovën në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare për zgjedhje demokratike.

- Dita e zgjedhjeve ishte e rregullt dhe e qetë, dhe vëzhguesit e EU EOM nuk raportuan ndonjë incident madhor. Vlerësimi i përgjithshëm i procesit të hapjes, votimit dhe numërimit ishte pozitiv. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) siguroi transparencën e procesit duke publikuar menjëherë në internet rezultatet preliminare jozyrtare për subjektet politike të zbërthyera sipas vendvotimeve.
- Korniza ligjore që rregullon këto zgjedhje mbetet i njëjtë si në zgjedhjet e fundit në 2017 meqë nuk është bërë asnjë reformë. Vazhdojnë të shfaqen mangësitë tashmë të identifikuar, siç është thirrja e zgjedhjeve të parakohshme brenda një afati të shkurtër kohor, periodha e parregulluar parazgjedhore, mungesa e transparencës dhe mbikëqyrjes së financimit të fushatave dhe aspektet kyçe të procesit që rregullohen vetëm me legjislacionin sekondar.
- KQZ funksionoi në mënyrë transparente dhe përkundër afatit të shkurtër, të gjitha përgatitjet zgjedhore përfunduan me kohë. Mekanizmi ekzistues i emërimeve për të tre nivelet e organeve të menaxhimit të zgjedhjeve ofroi përfshirje domethënëse të subjekteve politike përkatëse, duke përfshirë ato që përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë.

*Ky emërtim nuk e paragjykon qëndrimin ndaj statusit dhe është në përputhje me RKS KB 1244/1999 dhe mendimin e GjND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

- Procesi i regjistrimit ishte gjithëpërfshirës dhe që të gjitha 25 subjektet politike që aplikuan për të marrë pjesë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare u certifikuan nga KQZ. Gjithsej ishin 1,067 kandidatë, duke përfshirë 343 gra. Nuk pati kufizime të paarsyeshme për certifikimin e subjekteve politike ose certifikimin e pranueshmërisë së kandidatëve.
- Liria e fushatës u respektua në një fushatë të gjallë dhe konkurruese në pjesën më të madhe të Kosovës. Një varg tubimesh intensive u mbajtën nga të gjitha subjektet kryesore politike shqiptare të Kosovës gjatë periudhës zyrtare të fushatës zgjedhore. Sidoqoftë, liria e zgjedhjes së votuesve u dëmtua nga rastet e abuzimit të fondeve publike dhe pozitive të ndikimit nga autoritetet qendrore dhe lokale.
- Në komunitetin serb të Kosovës, partitë që synuan të garojnë me Srpska Lista nuk ishin në gjendje të zhvillojnë fushata efektive për shkak të frikësimit të kandidatëve, familjeve të tyre dhe votuesve në përgjithësi. Komunitatet e kontrolluara nga Srpska Lista, si dhe qeveria e Serbisë, i drejtuan serbët e Kosovës të votojnë vetëm për Srpska Lista, ndërsa kundërshtarët e tyre u denoncuan si anti-serbë. Kjo kufizoi ushtrimin e të drejtave themelore demokratike për lirinë e shprehjes, tubimit dhe përfaqësimit, dhe për rrjedhojë, procesi zgjedhor për serbët e Kosovës nuk i përmbushi këto standarde ndërkombëtare.
- Korniza rregullative nuk siguron transparencë dhe integritet të financimit të partive dhe fushatave. Në bazë të një interpretimi të gabuar të ligjit, shumë parti deklaruan se kishin planifikuar t'i raportojnë shpenzimet e tyre vetëm për dhjetë ditët e fushatës zyrtare, gjë që e kufizoi edhe më tej transparencën. Disa bashkëbisedues të EU EOM raportuan se partitë në pushtet i kompensojnë donatorët e tyre të mëdhenj me kontrata të prokurimit publik. Mbikëqyrja nuk përfshin identifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të paraportuara dhe nuk siguron llogaridhënie.
- Liria e mediave u respektua. Mediat audio-vizive i mundësuan votuesve qasje në pikëpamje të larmishme politike me mbulim të ekuilibruar në përgjithësi dhe duke organizuar debate gjithëpërfshirëse zgjedhore. Disa kanale televizive shkelën rregulloren për përmbajtjen me pagesë, duke përfshirë shfaqjen e reklamave politike gjatë debateve të tyre zgjedhore dhe politike. Komisioni i Pavarur i Mediave përgjithësisht dështoi të sanksionojë dhe të korrigjojë shkeljet e mediave audio-vizive gjatë fushatës. Mediat online, duke përfshirë uebsajtin e lajmeve të transmetuesit publik, shpesh shfaqën mbulim të njëanshëm.
- Facebook, rrjeti social më i popullarizuar në Kosovë, u përdor gjerësisht nga mediat tradicionale për të përçarur përmbajtjen e tyre editoriale, duke kontribuar në mundësinë e votuesve për të bërë zgjedhje të informuar. Garuesit gjithashtu e shfrytëzuan këtë platformë për të arritur deri te votuesit, duke përfshirë përdorimin e një sasive të konsiderueshme të reklamave. U shënuan raste të faqeve me origjinë të panjohur në Facebook që u shfrytëzuan për fushata njollosjeje. Sidoqoftë, Facebook ende nuk ka futur në përdorim politika për të siguruar plotësisht transparencën e reklamave politike dhe zgjedhore në Kosovë.
- Ligji parashikon kuotë gjinore prej 30 për qind për listat e kandidatëve, gjë që u aplikua me përpikëri nga partitë. Megjithatë, partitë politike kanë adoptuar masa të pamjaftueshme afirmative për të arritur përfaqësim të barabartë gjinor brenda partive politike, veçanërisht në nivelet lokale. Barazia gjinore ende nuk është integruar mjaftueshëm brenda ligjeve dhe politikave përkatëse.

- Saktësia dhe besueshmëria e listës së votuesve është problem i kahmotshëm. Lista përfundimtare e votuesve prej 1,937,868 votuesve ka më shumë votues të regjistruar sesa popullsia e vlerësuar rezidente për shkak të numrit të madh të diasporës dhe votuesve të vdekur në listën e votuesve.
- Më 9 shtator, KQZ adoptoi udhëzimin administrativ që thotë se vetëm dokumentet e identifikimit të lëshuara nga Kosova mund të përdoren për votim. Ky vendim u kundërshtua dhe u ankimua pa sukses nga Srpska Lista. Udhëzimi u nxor 26 ditë para ditës së zgjedhjeve, duke siguruar kështu kohë të arsyeshme për ata që nuk kishin dokument të vlefshëm identifikimi që të pajisen me një të tillë. Vëzhguesve të EU EOM nuk iu dhanë prova materiale se njerëzit nuk ishin në gjendje të marrin dokument të ri identifikimi.

Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i Bashkimit Evropian (EU EOM) ka qenë i pranishëm në Kosovë që nga 7 shtatori pas ftesës nga Presidenti Hashim Thaçi. EU EOM udhëhiqet nga Shefja e Misionit, Viola von Cramon-Taubadel, deputete e Parlamentit Evropian nga Gjermania. Gjithsej, EU EOM dërgoi në mbarë Kosovën 108 vëzhgues nga 27 shtete anëtare të BE-së, Norvegjia dhe Zvicra, për të vlerësuar tërë procesin zgjedhor në raport me detyrimet dhe zotimet ndërkombëtare për zgjedhje demokratike si dhe me ligjet e Kosovës. Misionit iu bashkua edhe delegacioni nga Parlamenti Evropian, i prirë nga Andrey Kovatchev, deputet i Parlamentit Evropian, që mbështet plotësisht këtë Deklaratë. Në ditën e zgjedhjeve, vëzhguesit vizituan 416 vendvotime në të gjitha 38 komunat e Kosovës për të vëzhguar votimin dhe numërimin. EU EOM është i pavarur në gjetjet dhe konkluzionet e tij dhe i përmbahet Deklaratës së Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve të nënshkruar në selinë e Kombeve të Bashkuara në tetor të vitit 2005.

Gjetjet

I. KONTEKSTI

Qeveria në largim, e udhëhequr nga Kryeministri Ramush Haradinaj, dha dorëheqje më 22 korrik 2019; Kuvendi i Kosovës u shpërnda një muaj më vonë. Më 26 gusht, Presidenti Thaçi shpalli zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e përbërë nga 120 vende për 6 tetor. Këto janë zgjedhjet e katërta parlamentare që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës..

Qeveria përbëhej nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) e Kryeministrit, Nisma për Kosovën (Nisma) dhe Aleanca Kosova e Re (AKR). Partitë jo-shumicë, duke përfshirë Listën Serbe (Srpska Lista) ishin gjithashtu pjesë e qeverisë kur ajo u formua. Dukej se qeveria kishte humbur efektivisht shumicën e vet në kohën e dorëheqjes.

Në këto zgjedhje, partitë më të mëdha opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Vetëvendosje (VV), garuan në mënyrë të pavarur, ashtu si edhe PDK. AAK formoi koalicion parazgjedhor me Partinë Social Demokrate (PSD). Nisma dhe AKR gjithashtu formuan koalicion parazgjedhor së bashku me Partinë e Drejtësisë (PD). Ishin katër parti që garonin për dhjetë vendet e garantuara për komunitetin serb të Kosovës. Këto ishin Srpska Lista, e cila kontrollon të gjitha komunat me shumicë serbe në Kosovë, Partia e Pavarur Liberale (SLS), Partia e Serbëve të Kosovës (PKS) dhe Koalicioni Liria (Sloboda) i sapokrijuar. Për dhjetë vendet e garantuara për komunitetet e tjera jo-shumicë ishin gjithsej 13 parti: nga tri për komunitetin boshnjak dhe goran, nga dy për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe një parti turke.

II. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Proces i hapur dhe gjithëpërfshirës i certifikimit të kandidatëve

Kushtetuta garanton lirinë e asociimit, si dhe të drejtën e çdo shtetasi që ka mbushur moshën 18 vjeç për t'u zgjedhur. Legjislacioni përkatës nuk përmban kufizime të paarsyeshme për certifikimin e subjekteve politike ose certifikimin e pranueshmërisë së kandidatëve.

U certifikuan që të gjitha 25 subjektet politike - katër koalicione të partive politike, 20 parti politike dhe 1 kandidat i pavarur - që aplikuan për certifikim për të marrë pjesë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2019. Më pas, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) i certifikoi gjithashtu listat e kandidatëve nga subjektet me 1,067 kandidatë. Të gjitha listat e kandidatëve me më shumë se dy kandidatë respektuan kuotën e detyrueshme gjinore prej 30 për qind. Në përgjithësi, procesi ishte gjithëpërfshirës, pa ndonjë polemikë madhore.

III. KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Korniza ligjore adekuate, por mangësitë e identifikuara më parë vazhdojnë

Liritë themelore të tubimit, asociimit, liria e shprehjes, barazia dhe mosdiskriminimi janë të parapara me Kushtetutë; e drejta për t'u zgjedhur, e drejta e votës dhe fshehtësia e votës garantohen edhe nga Kushtetuta edhe nga Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP). Korniza ligjore që rregulloi zgjedhjet e mëparshme në 2017 mbetet e njëjtë për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2019. Në përgjithësi, ofron kushte të përshtatshme për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike dhe konkurruese, në përputhje me standardet ndërkombëtare ndaj të cilave Kosova është zotuar përmes Kushtetutës së saj.¹ Një proces i reformës që kishte të bënte me ndryshimin e legjislacionit zgjedhor u fillua pak para shpërbërjes së Kuvendit, por nuk pati mundësi të përfundonte. Së këndejmi, nuk është zbatuar asnjë nga rekomandimet e bëra nga EU EOM në vitin 2017 që kërkoi ndryshime legjislative.

Dispozitat ligjore për thirrjen e zgjedhjeve të parakohshme në afat kohor të shkurtër,² thonë që KQZ ka të drejtën për të shkurtuar më tej afatet brenda kalendarit zgjedhor, përfshirë regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës, certifikimin e kandidatëve dhe periudhën zyrtare të fushatës, duke rritur kështu rrezikun e komprometimit të masave mbrojtëse dhe barazisë së mundësive politike. Aspekte të rëndësishme të procesit, siç janë regjistrimi i partive politike, përfaqësimi në nivele më të ulëta të administratës zgjedhore, procedurat në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), anulimi i rezultateve të zgjedhjeve, që do të duhej të përfshihen në LZP janë akoma të rregulluara me legjislacionin sekondar, d.m.th. Rregulloret e KQZ-së, dhe së këndejmi e komprometojnë sigurinë juridike.

Kosova është një zonë e vetme zgjedhore me sistem përfaqësimi proporcional me shumë parti me votim preferencial për deri në pesë kandidatë. Nga 120 deputetët e Kuvendit që zgjedhen me votim të fshehtë për mandat katër vjeçar, 20 vende janë të garantuara për komunitetet jo-shumicë, duke

¹ Neni 22 i Kushtetutës thekson zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të një varg instrumentesh të rëndësishme për zgjedhjet: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNJ). Pas anëtarësimit të Kosovës në Komisionin Evropian për Demokraci përmes Ligjit, i njohur si Komisioni i Venedikut, Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venedikut i tetorit 2002 zbatohet si referencë për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike.

² Zgjedhjet e parakohshme nuk mund të mbahen më herët se 30 dhe jo më vonë se 45 ditë pas shpërndarjes së Kuvendit.

përfshirë dhjetë për komunitetin serb të Kosovës.³ Nga ulëset që i caktohen një subjekti politik, secila gjini duhet të ketë të paktën 30 për qind të numrit të përgjithshëm të ulëseve të fituara nga subjekti politik.

IV. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Organ transparent i menaxhimit të zgjedhjeve dhe zgjedhje të përgatitura mirë nga aspekti teknik

Zgjedhjet u administruan nga një organ i menaxhimit të zgjedhjeve prej tri nivelesh, i përbërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), 38 Komisione Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) dhe 2,547 Këshille të Vendvotimeve (KVV). Mekanizmi ekzistues për emërim në KQZ, KKZ dhe KVV parashikon përfshirje domethënëse të subjekteve politike përkatëse, duke përfshirë subjektet politike jo-shumicë. KQZ aktualisht ka dhjetë anëtarë me një vend të lirë. Përveç kryesuesit jo-partiak, janë dy anëtarë të emëruar nga VV dhe LDK, dhe një nga PDK, Srpska Lista, koalicioni Vakrat, Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP) dhe Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK). AAK, partia e dytë më e madhe e koalicionit të mëparshëm PAN, nuk përfaqësohet në KQZ, meqë Presidenti nuk e konfirmoi emërimin e anëtarit të dytë të KQZ-së nga ky koalicion.⁴ Sidoqoftë, AAK është e përfaqësuar në nivel të KKZ dhe KVV.

KQZ dhe KKZ funksionojnë në mënyrë transparente dhe profesionale. Takimet e KQZ-së ku merren vendimet janë të hapura për publikun dhe vendimet në përgjithësi publikohen në uebsajtin e KQZ, megjithëse nganjëherë publikimi vonohet, disa vendime mungojnë, dhe ato jo gjithnjë publikohen në të dy gjuhët zyrtare. Vendimet zakonisht merren me konsensus, megjithatë, në disa raste nuk u arrit konsensusi dhe duhej të zbatohesh votimi me shumicë të thjeshtë. Këto përfshijnë vendimet për përbërjen në KKZ, caktimin e pozitave të kryesuesve në KVV dhe dokumentet e identifikimit të lejuara në ditën e zgjedhjeve.

Ekziston mungesë e qartësisë në ligj mbi dokumentet e identitetit që kërkohen për të vërtetuar identitetin e votuesve në ditën e zgjedhjeve. KQZ e sqaroi këtë çështje duke adoptuar udhëzime administrativ, sipas të cilit mund të pranohen vetëm dokumentet e identifikimit të lëshuara nga Kosova, d.m.th. mund të pranohen letërnjoftimi, pasaporta dhe patentë shoferi. Ky vendim u kundërshtua dhe u ankimua pa sukses nga Srpska Lista. KQZ miratoi udhëzimin 26 ditë para ditës së zgjedhjeve, duke siguruar kështu kohë të arsyeshme për ata që nuk kishin dokument të vlefshëm identifikimi që të pajisen me një të tillë. Vëzhguesve të EU EOM nuk iu dhanë prova materiale se njerëzit nuk kishin qenë në gjendje të marrin dokument të ri identifikimi para zgjedhjeve.

Përkundër kornizës kohore shumë të shkurtër prej 41 ditësh, të gjitha përgatitjet zgjedhore përfunduan me kohë dhe zgjedhjet ishin të përgatitura mirë teknikisht. Për KQZ u ndanë resurse të mjaftueshme financiare nga buxheti i Kosovës menjëherë pas shpalljes së zgjedhjeve. Trajnimi i më shumë se 17,000 pjesëtarëve të personelit të votimit në nivelin komunal u vlerësua nga vëzhguesit e EU EOM si përgjithësisht i kryer mirë. Përkundër numrit të madh të votave të pavlefshme në zgjedhjet e kaluara, edukimi i votuesve me sa duket nuk ishte prioritet për KQZ.

³ Dhjetë ulëset e mbetura ndahen si vijon: komunitetit Rom një (1) vend; komunitetit Ashkali një (1) vend; komunitetit Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali ose Egjiptian, i cili ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komunitetit Boshnjak tri (3) vende, komunitetit Turk dy (2) vende dhe komunitetit Goran një (1) vend.

⁴ Koalicioni PAN i përbërë nga PDK, AAK dhe Nisma, kishte të drejtë të caktonte dy anëtarë në KQZ. Presidenti konfirmoi emërimin e anëtarit nga PDK, mirëpo, ai nuk konfirmoi asnjërin prej dy të emëruarve të propozuar nga AAK dhe Nisma, përkatësisht.

Ekziston mungesë e masave mbrojtëse kundër identifikimit të rremë në sistemin e votimit me postë jashtë Kosovës dhe disa palë të interesuara shprehën shqetësime për besueshmërinë e procesit. Votimi për 35,094 votues që u regjistruan në listën e votuesve jashtë Kosovës, u mbyll në 5 tetor. Deri në këtë afat, KQZ ka pranuar 15,794 dërgesa postare me fletëvotime me kusht. Gjermania, Zvicra dhe Serbia përbëjnë më shumë se 70 për qind të aplikantëve të regjistruar dhe të refuzuar për votim jashtë Kosovës. Për shkak të afatit të shkurtër kohor, votuesit patën vetëm 12 ditë që të aplikojnë për votim jashtë Kosovës dhe lista e votuesve nuk ishte në dispozicion për shqyrtim publik gjatë periudhës së konfirmimit dhe kundërshtimit.

V. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Mungon besimi në saktësinë dhe besueshmërinë e listës së votuesve

Kushtetuta garanton të drejtën e votës për çdo qytetar që ka mbushur moshën 18 vjeç. LZP e bën çështjen e pranueshmërisë së votuesve edhe më gjithëpërfshirëse, duke i dhënë të drejtën e votës edhe jo-shtetasve, të cilët kanë të drejtë shtetësie. Kosova ka sistem pasiv të regjistrimit të votuesve, me anë të së cilit lista e votuesve përpilohet nga KQZ bazuar në ekstraktin e të dhënave që e siguron Agjencia e Regjistrimit Civil. Lista përfundimtare e votuesve prej 1,937,868 votuesve që nuk përfshin votuesit jashtë Kosovës u certifikua në 19 shtator.

Saktësia dhe besueshmëria e listës së votuesve është problem i kahmotshëm. Kosova ka më shumë votues të regjistruar sesa popullsia e vlerësuar rezidente. Kjo anomali shpjegohet pjesërisht me faktin se pjesa dërmuese e diasporës kosovare u përjashtuan nga regjistrimi i popullsisë i vitit 2011, ndonëse ata mbeten të regjistruar në mënyrë të ligjshme në regjistrin civil. Në mungesë të të dhënave të besueshme për popullsinë e diasporës, nuk është e mundur të vlerësohet nëse ky shpjegim është i justifikuar. Tutje, lista e votuesve përfshin shumë persona që kanë ndërruar jetë meqë nuk ekziston sistemi efektiv për heqjen sistematike të tyre. Një numër i madh i diasporës dhe votuesve të ndjerë në listën e votuesve e bëjnë procesin e votimit në ditën e zgjedhjeve të cënueshëm nga abuzimi i mundshëm.

VI. AMBIENTI I FUSHATËS

Fushatë konkurruese në pjesën më të madhe të Kosovës, ndonëse me keqpërdorim të avantazhit të subjekteve në pushtet; kishte mungesë themelore të konkurrencës në komunitetin serb të Kosovës

Periudha zyrtare e fushatës për këto zgjedhje të parakohshme u kufizua nga KQZ në 10 ditë krahasuar me 30 ditë për zgjedhje të rregullta. Megjithatë, disa nga partitë më të mëdha filluan fushatën disa javë para fillimit zyrtar të periudhës së fushatës. Mungesa e rregullave për periudhën 'para-fushatës' krijoi pasiguri midis palëve pjesëmarrëse në zgjedhje lidhur me mënyrat e lejuara të bërjes së fushatës dhe uli efektet e dobishme barazuese të rregullimit të fushatës.

Temat kryesore në fushatë kishin të bëjnë me pretendimet e korrupsionit dhe nepotizmit, dhe marrëdhëniet e ardhshme në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kishte mungesë të vëmendjes për programet e brendshme të partive, me fare pak programe thelbësore të botuara. Nga ana tjetër, fushatat e partive u përqendruan në mënyrë konsiderueshme në virtytet e kandidatëve të tyre për

kryeministër dhe dobësitë e pretenduara të kundërshtarëve të tyre. Ky përqendrim në personalitete dhe jo në politika, kufizoi mundësinë e votuesve për të bërë zgjedhje të informuara.

Liritë e fushatës përgjithësisht u respektuan. Gjatë periudhës zyrtare të fushatës, u mbajt një varg tubimesh intensive nga të gjitha subjektet kryesore që synojnë të përfaqësojnë shqiptarët e Kosovës. Në 48 tubimet e organizuara nga partitë e komunitetit shumicë, ku morën pjesë vëzhguesit afatgjatë nga BE, nuk pati raste të gjuhës inflamatore. Mirëpo, komunat nuk arritën të sigurojnë lokacione të aprovuara dhe hapësirë të barabartë për pllakatet e partive siç kërkohet, gjë që i shkoi për shtati partive më të mëdha me mundësi për të paguar për vendosjen e pllakateve në prona private.

Në disa raste, resurset e pushtetit qendror dhe lokal u vunë në veprim, me sa duket për avantazh politik.⁵ U raportuan raste të shumta të keqpërdorimit të pozitës në pushtet ku pretendohet se u ofruan ngritje në detyrë, zgjatje të kontratave të përkohshme ose pozita të reja në sektorin publik. Për shembull, ndërmarrjet shtetërore të energjisë elektrike dhe minierave shpallën një numër të madh të konkurseve të reja të punës pak para zgjedhjeve. Kishte gjithashtu pretendime se personeli mjekësor, punonjësit e postës dhe punonjësit në sektorin privat ishin nën presion për të marrë pjesë në takime, ku ata inkurajoheshin të votonin për një parti qeverisëse, duke minuar lirinë e zgjedhjes.

Qeveria e Serbisë dhe autoritetet lokale në komunat me shumicë serbe fuqimisht i drejtuan serbët e Kosovës që të votojnë vetëm për Srpska Lista. Në shumë raste, personat që kishin lidhje me kandidatët për parti që janë kundër Srpska Lista, dhe në të vërtetë votuesit në përgjithësi, u kërcënuan me largim ose pezullim nga pozitat e financuara nga Beogradi ose nga komunat.⁶ Partitë që dolën kundër Srpska Lista nuk ishin në gjendje të zhvillojnë fushatë efektive pjesërisht për shkak të mungesës së fondeve, por edhe për shkak të atmosferës së frikës në komunitetin serb të Kosovës, në të cilën kundërshtimi ndaj Srpska Lista u paraqit si vlerë anti-serbe. Policia hetoi disa raste të frikësimit të serbëve të Kosovës, që pretendohet të jenë bërë nga mbështetësit e Srpska Lista. Këto çështje nënkuptonin se liritë themelore të zgjedhjes dhe shprehjes në komunitetin serb të Kosovës nuk ishin respektuar sa duhet nga partia udhëheqëse, dhe as nuk mbroheshin nga autoritetet në komunat lokale ose institucionet e Kosovës. Kishte gjithashtu raporte që zyrtarëve serbë u ishte refuzuar hyrja në Kosovë gjatë periudhës së fushatës.

Zgjedhje konkurruese u bënë midis komuniteteve të tjera jo-shumicë, kryesisht me fushata derë më derë. Më shumë se 120 kandidatë nga tre subjekte politike dhe një kandidat i pavarur garuan për tre vende të garantuara për komunitetin boshnjak.⁷ Secili nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian kishte dy parti në garë zgjedhore. Fushatat e tyre u karakterizuan si nga konkurrenca brenda-komunitare ashtu dhe nga ajo ndër-komunitare. Komuniteti goran pati fushatë të ashpër midis tre partive. Vetëm një parti turke mori pjesë në zgjedhje, por me 30 kandidatë për dy vende të garantuara, votuesve iu siguria hapësirë për zgjedhje.

⁵ Ministria e Bujqësisë shpalli skemën prej 3 milionë euro për grante deri në 15,000 euro për fermerët e vegjël më 17 shtator. Në të njëjtën ditë, Ministria në largim e Bujqësisë (kandidate për SLS) postoi një video në faqen e saj personale në Facebook me flamur të spikatur të SLS në plan të parë, duke promovuar skemën. Më 18 shtator, Ministri në largim i Novacionit dhe Ndërmarrësisë (PDK) nisi fondin për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me vlerë prej 4 milionë euro.

⁶ Largimet dhe pezullimet e pretenduara me motive politike kishin të bëjnë me punëtorët e shëndetësisë, postës si dhe ata komunalë. Nxitja e votuesve përfshiu gjithashtu premtime si ato për 1000 vende pune nga Srpska Lista. Presidenti Vuçiq u kritikua nga partitë e opozitës serbe pasi që kishte lënë të kuptohet se do të rrezikoheshin vendet e punës të financuara nga Beogradi nëse të dhjetë vendet për komunitetin serb nuk fitohen nga Srpska Lista.

⁷ Kishte 374 kandidatë për 10 vendet e garantuara për komunitetet jo-shumicë (përveç serbëve të Kosovës). Kjo krahasohet me 643 kandidatë për 100 vendet që nuk janë të garantuara për ndonjë komunitet të veçantë.

VII. FINANCIMI I FUSHATËS

Mungon transparenca për të ardhurat dhe shpenzimet e partive, në një kornizë jo-adekuate rregullative

Financimi i partive dhe fushatave rregullohet me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike të vitit 2010 (LFSP, i ndryshuar për herë të fundit në vitin 2013), Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme i vitit 2008 dhe rregullat e KQZ. Më herët gjatë këtij viti, Kuvendi nuk arriti të miratojë projektligjin për ndryshimin e LFSP, i cili ishte vlerësuar si “hap i rëndësishëm në drejtimin e duhur”.⁸ Korniza rregullative nuk siguron raportim të saktë, shpalosje me kohë, mbikëqyrje apo llogaridhënie domethënëse për parregullsitë.

Partitë e përfaqësuara në Kuvend marrin fonde publike.⁹ Përveç kësaj, të gjitha partitë mund të marrin donacione deri në 2,000 euro nga personat fizikë dhe 10,000 euro nga personat juridikë. Ekzistojnë gjithashtu ndalime për burime të caktuara të donacioneve, por asnjë autoriteti nuk i është dhënë mandati për të verifikuar pajtueshmërinë. Ndërsa ka mbledhje të kufizuar të fondeve nga baza, partitë mbështeten në fondet publike. Disa bashkëbisedues të EU EOM pohojnë se partitë në pushtet i kompensojnë donatorët e tyre duke u dhënë kontrata të prokurimit publik. Sipas ligjit, të gjitha transaksionet duhet të bëhen me transferim bankar përmes llogarisë bankare të partisë. Sidoqoftë, donacionet dhe pagesat bëhen shpesh me para të gatshme ose në bazë të mirësisë dhe mbeten të paraportuara. Disa kandidatë informuan misionin se ata individualisht morën kontribute dhe kryen pagesa, që është në kundërshtim me ligjin, meqë anashkalojnë llogarinë bankare të partisë dhe mbeten të paraportuara.

Një subjekt politik mund të shpenzojë deri në 0.5 EUR për votues të regjistruar që arrin në 986,233 EUR në mbarë Kosovën. Ligji parashikon që të gjitha shpenzimet e bëra për qëllime fushate duhet të raportohen madje edhe nëse ato janë bërë para thirrjes së zgjedhjeve. Sidoqoftë, disa parti deklaruan se ata do të raportojnë vetëm shpenzimet e bëra gjatë dhjetë ditëve të periudhës zyrtare të fushatës, gjë që ul ndjeshëm transparencën. Bashkëbiseduesit e EU EOM vunë në pah se palët ngurrojnë të raportojnë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e tyre, për shkak të ligjshmërisë së tyre të dyshimtë.

Shpalosja nuk bëhet me kohë dhe mbikëqyrja është e paefektshme. Subjekteve politike u kërkohet të paraqesin raporte të financimit të fushatës në KQZ brenda 45 ditëve nga dita e zgjedhjeve. Sidoqoftë, Komisioni Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike mund të emërojë auditorë të certifikuar vetëm në vitin vijues dhe auditimi nuk mund të përfundojë para qershorit 2020. Zyra për Regjistrim dhe Certifikim të Partive Politike në KQZ publikon raportet financiare të partive vetëm pas auditimit, gjë që vonon më tej shpalosjen. Për më tepër, KQZ nuk ka publikuar në uebsajtin e saj regjistrin e të gjitha donacioneve të bëra për subjektet politike, siç kërkohet me ligj.

Auditorët, të cilëve u kërkohet vetëm të verifikojnë përmbajtjen e raporteve financiare, kanë ngritur shqetësime për saktësinë e tyre. As nga Komisioni dhe as nga KQZ nuk kërkohet që të identifikojnë të ardhurat dhe shpenzimet e paraportuara ose parregullsitë e tjera të mundshme, gjë që nuk siguron

⁸ Shih Mendimi i Komisionit të Venedikut 922/2018 për Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike. Ky projektligj kaloi leximin e parë në Kuvend, por ai u ndryshua në mënyrë drastike dhe në fund u tërhoq.

⁹ Në vitin 2019, 4.2 milionë euro u ndanë për 13 subjekte politike me ulëse në Kuvend. Gjegjësisht, PAN (PDK, AAK, Nisma) mori 1,365,000 EUR, VV 1,120,000 EUR, LDK dhe AKR 1,015,000 EUR, Srpska Lista 315,000 EUR, KDPT dhe Koalicioni Vakrat 70,000 EUR secila, shtatë parti të tjera jo-shumicë morën 35,000 EUR secila.

mbikëqyrje domethënëse. Pavarësisht nga kërkesa ligjore, disa parti politike nuk publikuan raportet e tyre financiare në uebsajtet e tyre, por nuk u janë shqiptuar sanksione. Për më tepër, disa bashkëbisedues të EU EOM mendojnë se sanksionet ekzistuese (kryesisht gjopa që shkojnë nga 1,000 deri në 5,000 EUR) nuk janë dekurajuese dhe efektive në krahasim me shumat në fjalë në fushën e financimit të partive.

VIII. MEDIAT

Mediat dhe rrjetet sociale i mundësuan votuesve qasje në informacion mbi pikëpamjet e ndryshme politike

Ambienti pluralist dhe i gjallë i mediave i mundësoi votuesve qasje në pikëpamje të larmishme politike. Burimet kryesore të informimit të votuesve mbi zgjedhjet ishin kanalet televizive krahas mediave në internet dhe rrjeteve sociale, gjegjësisht Facebook. Korniza ligjore ofron masa të shëndosha mbrojtëse për lirinë e mediave dhe gazetarët ishin në gjendje të punojnë lirshëm.

LZP kërkon që të gjitha mediat të sigurojnë mbulim korrekt dhe të drejtë për të gjitha subjektet politike gjatë fushatës zyrtare zgjedhore. Ligji gjithashtu parashikon hapësirë minimale të transmetimit falas për të gjithë konkurrentët. Përmbajtja me pagesë lejohet gjatë periudhës zyrtare të fushatës zgjedhore, por, përderisa përdorimi i spoteve politike me pagesë rregullohet rreptësisht, ka një boshllëk në rregull që i lejon subjektet politike të blejnë sasi të pakufizuar të mbulimit me pagesë të aktiviteteve të tyre të fushatës në median audio-vizive. PDK, AAK-PSD dhe LDK përfituan nga kjo duke përdorur gjerësisht mbulimin me pagesë, përveç spoteve politike me pagesë. Për më tepër, disa kanale televizive shkelën rregullat duke shfaqur reklama politike me pagesë gjatë debateve dhe programeve të tyre politike. Prandaj, programet e krijuara për të informuar votuesit, u shndërruan në edhe një mjet për reklamim politik. EU EOM vërejti disa shkelje të mediave në lidhje me spotet politike me pagesë dhe programet e sponsorizuara të cilat nuk ishin emërtuar siç duhet. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e mediave audio-vizive, përgjithësisht dështoi të sanksionojë dhe të korrigjojë shkeljet gjatë fushatës zgjedhore.

Kanalet televizive dhe mediat online të monitoruara nga misioni filluan mbulimin e aktiviteteve zgjedhore të partive politike dhe mbajtën debate televizive shumë përpara fillimit të fushatës zgjedhore.¹⁰ Monitorimi i mediave nga EU EOM tregoi që kanali televiziv publik *RTK1* në dhjetë ditët e fundit të para-fushatës dhe gjatë periudhës zyrtare të fushatës, ofroi mbulim kryesisht të ekuilibruar të subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend në emisionet e lajmeve. Megjithatë, në uebsajtin e lajmeve transmetuesi kishte mbulim të gjerë dhe mjaft pozitiv për PDK, me më pak mbulim për partitë e tjera dhe, ndonjëherë, mbulim negativ për LDK. Kanalet televizive private të tilla si *RTV21*, *KTV*, *Klan Kosova* dhe *T7*, ofruan mbulim përgjithësisht të ekuilibruar me lajme, dhe organizuan debate të shumta gjithëpërfshirëse zgjedhore. Sidoqoftë, përkundër përpjekjeve nga mediat për të adresuar tema dhe politika specifike, përfaqësuesit e partive nuk u përqendruan në propozime konkrete të platformave politike, duke minuar mundësinë e votuesve për të bërë zgjedhje të informuar.

¹⁰ Nga 14 shtatori deri më 6 tetor, EU EOM kreu monitorim cilësor dhe sasior të një mostre të kanaleve televizive (*RTK1*, *RTK2*, *KTV*, *RTV21*, *Klan Kosova*, *T7*, *TV Most* dhe *Puls TV*), si dhe monitorimin e një mostre të mediave të lajmeve në internet. Rezultatet e hollësishme të monitorimit të mediave do të përfshihen në Raportin Përfundimtar të EU EOM.

Burimi kryesor i lajmeve për komunitetin serb të Kosovës janë mediat audio-vizive nga Serbia. Kanali televiziv publik i Kosovës që transmeton në gjuhët jo-shumicë, RTK2, i cili nuk është i qasshëm në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës, ofroi ca hapësirë transmetimi falas dhe organizoi debatet midis partive politike që përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë. Srpska Lista refuzoi të marrë pjesë në çdo debat. Disa media nga Serbia dhe një uebsajt i lajmeve në gjuhën serbe në Kosovë pohuan se ishin kufizuar përkohësisht nga mbulimi i lirshëm i zgjedhjeve.¹¹

Mediat në internet dhe rrjetet sociale nuk janë të rregulluara.¹² Disa media në internet shfaqën linja editoriale partiake, duke mbështetur ose diskredituar subjektet politike. Facebook u përdor kryesisht nga mediat tradicionale dhe ato online për të transmetuar drejtpërdrejt dhe ripublikuar përmbajtjen e tyre editoriale dhe për të rritur audiencën. Garuesit e shfrytëzuan rrjetin Facebook për të arritur deri te votuesit me mesazhe të sponsorizuara, për të mobilizuar votuesit gjatë fushatës dhe për të transmetuar drejtpërdrejt ngjarjet e fushatës. EU EOM vuri re raste të faqeve në Facebook të përkatësisë së panjohur që bënë fushata njollosjeje duke përhapur sistematikisht mesazhe me pagesë me përmbajtje çorientuese, dhe, nganjëherë, të rreme. Përderisa kishte pasur reklama të konsiderueshme të fushatës në Facebook në Kosovë, rrjeti social ende nuk e ka zbatuar politikën e tij, të adoptuar në vende të tjera, për të siguruar transparencë të plotë të reklamave zgjedhore.¹³ Kjo do t'i kishte mundësuar votuesve që ta dinë burimin e mesazheve të sponsorizuara, si dhe do ta kishte bërë të mundur vlerësimin e shpenzimeve të subjekteve politike në këtë platformë sociale.

IX. PJESËMARRJA E GRAVE

Përderisa dispozitat ligjore për barazi gjinore duhet të harmonizohen, gratë mbeten të përfaqësuara në mënyrë të pamjaftueshme, veçanërisht në nivelin lokal

Barazia gjinore është e mishëruar në dispozita të ndryshme të Kushtetutës. LQP parashikon kuotë minimale prej 30 për qind për secilën gjini në çdo listë të kandidatëve, si dhe në caktimin e ulëseve në Kuvend. Sidoqoftë, versioni më i fundit i Ligjit për Barazi Gjinore,¹⁴ parashikon barazi strikte të përfaqësimit prej 50 për qind. Këto dispozita nuk janë harmonizuar, çështje kjo që u ngre në disa raste nga përfaqësuesit e organizatave të të drejtave të grave dhe u kundërshtua nga Avokati i Popullit në gjykatë disa ditë para zgjedhjeve.¹⁵ Janë 1,067 kandidatë të certifikuar, nga të cilët 343 gra, që përfaqësojnë 32.15 përqind të totalit të kandidatëve, në përputhje me kuotën e parashikuar në LQP. Ishte vetëm një grua e deklaruar që garonte si kandidate për kryeministër. Platformat politike nuk adresojnë mjaftueshëm çështjet gjinore dhe pjesëmarrja e grave në tubimet e vëzhguara nga vëzhguesit afatgjatë ishte mesatarisht 23 për qind, ndërsa folëset përbënë 22 për qind të totalit të folësve në tubimet e vëzhguara. Rrjeti i Grave të Kosovës përmes rrjetit të tyre me OJQ inicioi

¹¹ Për shembull, më 4 tetor, një ekip gazetarësh nga Radio Beogradi pohoi se ishte mbajtur në ndalim në një stacion policie në Mitrovicën e Jugut për gjashtë orë pa arsye. Uebsajti i lajmeve Kossev.info pohoi se kishte rënë viktimë e sulmit kibernetik, ku si rrjedhojë uebsajti nuk ishte funksional për disa orë në ditën e zgjedhjeve.

¹² Facebook shquhet në masë shumë të madhe si rrjeti social më i popullarizuar në Kosovë. Instagram është më pak i popullarizuar dhe nuk përdoret shumë për qëllime politike, ndërsa Twitter ka numër shumë të kufizuar të përdoruesve, dhe nuk luajti rol të rëndësishëm.

¹³ Në disa vende, Facebook gradualisht po fut në përdorim një "[proces për autorizim të reklamave](#)" për reklamuesit që publikojnë shpallje lidhur me çështje sociale, zgjedhore apo të politikave me qëllim të rritjes së transparencës së përmbajtjes lidhur me këto çështje në platformën e vet.

¹⁴ Ligji për Barazi Gjinore (Nr. 05/L-020) u adoptua më 28 maj 2015 duke shfuqizuar Ligjin për Barazi Gjinore (Nr. 2004/2), në përputhje me CEDAW dhe disa Direktiva të BE për barazi gjinore.

¹⁵ Avokati i Popullit doli me deklaratë publike më 5 shtator 2019 mbi epërsinë e dispozitave të Ligjit për Barazi Gjinore mbi dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Më 27 shtator, Avokati i Popullit paraqiti padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër KQZ për diskriminim gjinor në listat e kandidatëve të subjekteve politike.

fushatë të gjerë derë më derë në të gjithë Kosovën në mënyrë që votuesit të votojnë për gratë pa marrë parasysh pikëpamjet e tyre politike.¹⁶

KQZ kryesohet nga një grua, megjithatë përfaqësimi i grave në nivelet e ulëta të administrimit zgjedhor mbetet i ulët me vetëm 14 për qind të anëtarëve në KKZ. Në mënyrë të ngjashme, në vendvotimet e vëzhguara nga EU EOM, vetëm 19 për qind ishin të kryesuara nga gratë dhe, në KVV në tërësi, gratë përbënë 28 për qind të anëtarëve të komitetit të vendvotimit. Në vendvotimet e vëzhguara nga misioni, 26 për qind e vëzhguesve partiakë dhe 44 për qind e vëzhguesve vendas ishin gra.

X. VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE

Kosova ka rrjet të vendosur mirë të vëzhguesve vendorë të bazuar në shoqërinë civile që koordinohet nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) nën flamurin e Demokracisë në Veprim (DnV). Në periudhën parazgjedhore DnV dërgoi 72 vëzhgues afatgjatë në mbarë Kosovën për të vëzhguar fushatën dhe për të monitoruar shpenzimet e fushatës të subjekteve politike në garë zgjedhore. Në ditën e zgjedhjeve, DnV dërgoi mbi 2,500 vëzhgues që mbuluan të gjitha vendvotimet. DnV doli me disa raporte për fushatën zgjedhore, procesin e votimit dhe numërimit, dhe bëri tabelimin e plotë paralel të votave. Në përgjithësi, prania e madhe e vëzhguesve të shoqërisë civile kontribuoi në transparencën e procesit në ditën e zgjedhjeve.

XI. VOTIMI DHE NUMËRIMI

Dita e zgjedhjeve ishte e rregullt dhe e qetë dhe procesi i zhvilluar i votimit dhe numërimit u vlerësua pozitivisht

Dita e zgjedhjeve ishte e rregullt dhe e qetë, dhe vëzhguesit e EU EOM nuk raportuan ndonjë incident madhor. Të 38 vendvotimet ku misioni vëzhgoi procesin e hapjes u hapën me kohë ose me vonesë prej më pak se 30 minuta. Procedurat e hapjes u ndoqën kryesisht dhe zhvillimi i përgjithshëm i procesit të hapjes u vlerësua pozitivisht në të gjithë, përveç një vendvotimi të vëzhguar.

Votimi u vëzhgua në 416 vendvotime në të gjitha 38 komunat. Zhvillimi i përgjithshëm i procesit të votimit u vlerësua pozitivisht në më shumë se 95 për qind të vendvotimeve të vëzhguara. Vëzhguesit nga subjektet politike dhe shoqëria civile ishin të pranishëm në 94 dhe 91 për qind përkatësisht të vendvotimeve të vizituara, duke rritur besimin e palëve të përfshira në proces. Ndërsa vlerësimi i përgjithshëm ishte pozitiv, vëzhguesit e EU EOM gjithashtu vunë re disa parregullsi. Asistenca e tepërt për votuesit u vëzhgua në shumë nga vendvotimet e vizituara, ku i ofrohej asistencë votuesve që me sa duket nuk kishin nevojë për ndihmë. Përpjesa e votuesve që u ndihmuan për plotësimin e fletëvotimit në disa vendvotime shkon madje nga 15 deri në 22 për qind. Më shumë se dy vëzhgues nga një subjekt politik ishin të pranishëm në 15 për qind dhe raste të votimit familjar ose grupor u vëzhguan në 10 për qind të vendvotimeve të vizituara. Votuesit jo gjithmonë e plotësuan fletëvotimin e tyre në fshehtësi në 9 për qind të vendvotimeve të vizituara.

Performanca e stafit në KVV u përkeqësua gjatë procesit të mbylljes dhe numërimit dhe vetëm 28 nga 39 numërime të kryera në vendvotim u vlerësuan pozitivisht. Kjo kryesisht për shkak të faktit

¹⁶ Shpërndarja e fletushkave me sloganin “Voto për më shumë gra në Parlament!”

se procedurat mjaft komplekse të mbylljes dhe numërimit shpesh nuk u ndoqën. Vëzhguesit e subjekteve politike ishin të pranishëm në 36 dhe vëzhguesit e shoqërisë civile në 37 vendvotime të vëzhguara gjatë numërimit. Dorëzimi dhe marrja e materialit të vendvotimeve u vëzhgua nga 25 ekipe në 24 nga 38 qendrat e pranimi në KKZ. Procesi u vlerësua pozitivisht në 25 nga 26 vëzhgime.

Nga aspekti pozitiv, KQZ siguroi transparencën e procesit të numërimit duke publikuar menjëherë në internet rezultatet preliminare jozyrtare për subjektet politike të zbërthyer sipas vendvotimeve brenda disa orësh pas përfundimit të numërimit të rregullt të votave në qendrat e votimit.

Në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës, si edhe në zgjedhjet e mëparshme, OSBE ofroi asistencë teknike për Komisionet Komunale të Zgjedhjeve dhe që të gjitha 86 Këshillat e Vendvotimeve. Stafi i OSBE pati rol këshillues pa kompetenca ekzekutive.

XII. KONTESTET ZGJEDHORE

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), institucion i pavarur përgjegjës për të shqyrtuar ankesat dhe parashtresat lidhur me zgjedhjet, deri më 5 tetor, kishte pranuar 86 parashtresa lidhur me vendimet e KQZ dhe 247 ankesa. Të gjitha parashtresat dhe ankesat deri më tani janë shqyrtuar brenda afatit të përcaktuar. Mbi 240 ankesa të paraqitura kishin të bënin me shkeljet e Kodit të Sjelljes gjatë periudhës së fushatës dhe periudhës së heshtjes zgjedhore duke rezultuar në shuma të konsiderueshme të gjobave të shqiptuara.¹⁷ U shqiptua gjobë prej 30,000 eurosh për spotin e fushatës zgjedhore nga Srpska Lista i cili, në një interpretim të përgjithshëm të dispozitës ligjore përkatëse, u vlerësua se shkel Kodin e Sjelljes për subjektet politike. Deri më tani, vendimet e PZAP janë vërtetuar në gjashtë nga tetë rastet që arritën në Gjykatën Supreme, duke përfshirë ankesën e paraqitur nga Srpska Lista ndaj vendimit të PZAP për dokumentet e pranueshme të identifikimit në ditën e zgjedhjeve.

Versioni elektronik i kësaj Deklarate Paraprake është në dispozicion në uebsajtin e Misionit:

www.eomkosovo2019.eu

Për informata të mëtejme, ju lutem të kontaktoni:

Marek Mracka, Zyrtar për Shtyp dhe Informim Publik, EU EOM

+383 49 405 780 marek.mracka@eomkosovo2019.eu

Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i Bashkimit Evropian në Kosovë 2019, Hotel Swiss Diamond, Prishtinë

¹⁷ Gjithsej gjobat e shqiptuara gjer tani kanë arritur në 328,450 EUR. PDK u gjobit me 91,700 EUR, AAK-PSD 82,400 EUR, LDK 74,300 EUR, Srpska Lista 36,100 EUR dhe Nisma-AKR-PD 33,000 EUR.